

## **Binjakëzimi midis komunave Casalvecchio di Puglia dhe Zhurit të Kosovës**

Dita e enjte, datë 25 shtator 2008, shënoi një ngjarje me rëndësi të madhe historike. Në Casalvecchio di Puglia në orën 18, këshilli komunal i përbashkët Casalvecchio-Zhur vulosi binjakëzimin midis dy komunave.

Këshilli komunal i Casalvecchio-s qysh në mbledhjen e datës 5 qershor kishte miratuar binjakëzimin me Zhurin, një qytezë e Kosovës me 12 mijë banorë, duke pasur parasysh këtë motivim: *“që të njihen më nga afër fshati ynë dhe i juaji; për të mbrojtur traditat dhe zakonet tona, të lashta por shumë të çmuara; për të vazhduar ruajtjen dhe zhvillimin e arbëreshëve, për të njohur zhvillimin tuaj shkollor, kulturor, industrial dhe ekonomik; për të njohur mundësitë dhe ndihmën e ndërsjelltë në të gjitha fushat e jetës. Më këtë binjakëzim do të mund të garantojmë mbrojtjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve tona vëllazërore, që duhet të vazhdojnë të marrin frymë si një pemë e madhe dhe e fortë e mbështetur mbi rrënjët e përbashkëta shumë të lashta.”*

Kryetari i bashkisë së Casalvecchio-s, Michele Boccamazzo, duke iu përgjigjur kërkesës së këshillit komunal të Zhurit, deklaroi se ishte i gatshëm dhe që *“e pranon më shumë gëzim kërkesën për të filluar një binjakëzim të përzemërt me ju, vëllezër shqiptarë, dhe për të zhvilluar shkëmbime plot dashuri pas më shumë se sa pesëqind vjetësh nga vdekja e Skënderbeut dhe që kur stërgjyshërit tanë mbërritën në Itali për të ruajtur lirinë dhe identitetin e tyre dhe për të jetuar larg nga pushtuesit turq. Ne jemi shumë të kënaqur që ju arritët pavarësinë, që është e domosdoshme për çdo popull që të jetojë i lirë dhe autonom”*.

Në mbledhjen e Këshillit Komunal Kryetari i bashkisë Michele Boccamazzo nënvizoi se bëhet fjalë për binjakëzimin e parë midis një komune italiane dhe një komune të Kosovës.

Kryetari i bashkisë së Zhurit, Bedri Hoxhaj, që kryesonte një delegacion prej 16 anëtarësh, në fillim të fjalimit të tij falënderoi Qeverinë italiane dhe popullin italian për ndihmesën e tyre për pavarësinë e Kosovës dhe pastaj vuri në dukje rëndësinë e marrëdhënieve kulturore sidomos për mbrojtjen dhe për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në komunat arbëreshe. Në delegacionin ksovar bënte pjesë edhe profesor Imri Badallaj, me origjinë nga komuna e Zhurit, studiues shumë i njohur, i cili prej më se 30 vjetësh është i angazhuar drejtpërsëdrejti edhe në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Arbërisë. Provë e këtij angazhimi të tij janë, midis të tjerash, hapja e mësimdhënies së gjuhës dhe të letërsisë shqipe për Shqiptarët e Italisë në Universitetin e Prishtinës, studimet e tij të shumta mbi autorët arbëreshë dhe përpjekjet për të mbajtur gjithmonë të gjalla marrëdhëniet midis arbëreshëve dhe kosovarëve, duke përkrahur dhe nxitur pjesëmarrjen e studentëve dhe të studiuesve të rinj arbëreshë në veprimtarinë didaktike dhe kulturore të Universitetit të Prishtinës. Në fjalimin tij profesor Badallaj nënvizoi se *“të gjithë arbëreshët duhet të flasin shqip kudo që ndodhen, dhe kjo vlen edhe për brezat e reja dhe për fëmijët e arbëreshëve”*.

Një rol të pazëvendësueshëm pati në këtë binjakëzim profesori Mario Massaro, arbëresh nga Chieuti, promuovues i binjakëzimit dhe një figurë e rëndësishme në marrëdhëniet midis Kosovës dhe Arbërisë prej disa dhjetëvjeçarësh.

Të gjithë pjesëmarrësit në këtë ceremoni – ishin të pranishëm edhe kryetarët e bashkive të disa fshatrave të tjera arbëreshe – ndoqën me shumë vëmendje fjalimin e profesorit Italo Costante Fortino, titullar i katedrës së gjuhës dhe të letërsisë shqipe dhe Shef i Departamentit të Studimeve të Evropës Lindore të Universitetit të Napolit “L’Orientale”.

Profesor Fortino foli për Kosovën dhe për kosovarët, për historinë e tyre, për kulturën e tyre dhe për ndihmesën e tyre në fushën e letrave shqipe. Pastaj nënvizoi rëndësinë shumë të madhe të binjakëzimit midis komunave të Casalvecchio-s dhe të Zhurit, një dritare e hapur drejt Evropës, me perspektiva zhvillimi, përveç se në fushën kulturore, edhe në atë ekonomike.

Një çast plot emocione ishte paraqitja e dhuratave që delegacioni kosovar i solli komunës së Casalvecchio-s: prodhime tipike kosovare, kostume popullore të Shqipërisë së veriut, flamuri i Kosovës me hartën e Kosovës, me gjashtë yjet që simbolizojnë gjashtë etnitë e saj, në sfond të kaltër, dhe një flamur i madh kombëtar shqiptar me ngjyrë të kuqe dhe më shqiponjën e zezë dykrenare.

Pas ceremonisë të gjithë të pranishmit ndoqën me shumë interes shfaqjen e përgatitur nga nxënësit e shkollës së Casalvecchio-s në teatrin Santa Maria delle Grazie: këngë shqiptare, këngë popullore arbëreshe dhe këngë të famshme të muzikës së lehtë italiane të përkthyer në arbërisht, për të përfunduar pastaj me një valle ku nxënësit ishin të veshur me kostume popullore arbëreshe.

Programi i binjakëzimit vazhdoi deri të hënën, datë 29 shtator, me vizita në territorin e Casalvecchio-s: Terme di Castelnuovo, Mulino De Vita, Biscottificio De Mauro, Pastificio Andreola, ndërmarrje bujqësore të rajonit; vizitë në Luçera (kështjella, katedralja, muzeu); vizitë në ndërmarrjen Massaro në Chieuti; vizitë në panairin e produkteve dhe të pajisjeve bujqësore San Matteo në Casalvecchio.

Kjo ngjarje u pasqyrua gjerë edhe nga shtypi kombëtar italian dhe nga shtypi krahinor.

F.to Edmond Çali

## **Gemellaggio tra i comuni di Casalvecchio di Puglia e Zhur della Kosova**

Un evento di grande importanza storica e culturale ha avuto luogo giovedì 25 settembre 2008 a Casalvecchio di Puglia. Alle ore 18, il consiglio comunale congiunto Casalvecchio-Zhur ha suggellato il gemellaggio tra i due comuni.

Il consiglio comunale di Casalvecchio già nella seduta del 5 giugno scorso aveva approvato il gemellaggio con Zhur, un paese di 12 mila abitanti della Kosova, adducendo le seguenti motivazioni: *“perché si conoscano più da vicino il nostro paese ed il vostro; per tutelare gli usi ed i costumi nostri, antichi ma molto preziosi; per continuare la conservazione e lo sviluppo degli arbëreshë; per conoscere il vostro sviluppo scolastico, culturale, industriale ed economico; per conoscere le possibilità e gli aiuti reciproci in tutti i campi della vita. Con questo gemellaggio potremo garantire la tutela e lo sviluppo dei nostri rapporti fraterni, che devono continuare a respirare come un grande e forte albero fondato sulle comuni radici molto antiche”*.

Il sindaco di Casalvecchio, Michele Boccamazzo, in risposta si dichiarava pronto ad *“accettare con molta gioia la richiesta per iniziare un gemellaggio cordiale con voi, fratelli albanesi, e per sviluppare scambi affettuosi dopo cinquecento anni e più dalla morte di Scanderbeg e da quando i nostri antenati sono giunti in Italia per conservare la loro libertà ed identità e per vivere lontani dai Turchi invasori. Noi siamo molto contenti che voi abbiate ottenuto l'indipendenza, che è indispensabile ad ogni popolo per crescere libero ed autonomo”*.

Nella riunione del consiglio comunale il sindaco Michele Boccamazzo ha sottolineato che si tratta del primo gemellaggio tra un comune italiano ed un comune della Kosova.

Il sindaco di Zhur, Bedri Hoxhaj, a capo di una delegazione di 16 persone, all'inizio ha ringraziato il governo ed il popolo italiano per il loro contributo dato per l'indipendenza della Kosova e poi ha messo in evidenza l'importanza dei rapporti culturali soprattutto per la tutela e lo sviluppo della lingua e della cultura albanese nei comuni arbëreshë.

Della delegazione kosovara faceva parte anche il professor Imri Badallaj, originario del comune di Zhur, insigne studioso ed esponente di spicco della cultura kosovara, impegnato da più di 30 anni in prima persona anche nei rapporti tra la Kosova e l'Arbëria. Prova di questo suo impegno sono, tra l'altro, l'apertura dell'insegnamento della lingua e letteratura degli Albanesi d'Italia nell'Università di Prishtina, i suoi numerosi studi sugli autori arbëreshë e gli sforzi per mantenere sempre vivi i rapporti tra gli arbëreshë e i kosovari, incentivando la partecipazione di studenti e giovani studiosi arbëreshë all'attività didattica e culturale dell'università di Prishtina. Nel suo intervento il professor Badallaj ha sostenuto che *“tutti gli arbëreshë devono parlare albanese ovunque si trovino, e ciò vale anche per le nuove generazioni e per i figli degli arbëreshë”*.

Un ruolo insostituibile in questo gemellaggio ha avuto il professor Mario Massaro, arbëresh di Chieuti, promotore del gemellaggio e presenza importante nei rapporti tra la Kosova e l'Arbëria da decenni.

I partecipanti alla cerimonia - erano presenti anche sindaci di altri paesi arbëresh - hanno seguito con molta attenzione l'intervento del professor Italo Costante Fortino, ordinario di lingua e letteratura albanese e Direttore del Dipartimento di Studi dell'Europa Orientale dell'Università degli Studi di Napoli "L'Orientale".

Il professor Fortino ha parlato della Kosova e dei kosovari, della loro storia, della loro cultura e del loro contributo nel campo delle lettere albanesi. Ha, infine, sottolineando l'importanza notevole del gemellaggio tra i comuni di Casalvecchio e Zhur della Kosova, una finestra aperta verso l'Europa, con prospettive di sviluppo, oltre che nel campo culturale, anche in quello economico.

Un momento di grande emozione è stato la presentazione dei regali offerti al comune di Casalvecchio dalla delegazione kosovara: prodotti tipici kosovari, costumi popolari dell'Albania del nord, la bandiera della Kosova con la raffigurazione della Kosova, circondata da sei stelle simboleggianti le sue sei etnie, su sfondo azzurro, e una grande bandiera nazionale albanese rossa con l'aquila bicipite nera.

Dopo la cerimonia tutti i presenti hanno seguito con molto interesse lo spettacolo allestito dagli alunni dell'Istituto Comprensivo nel teatro S. Maria delle Grazie: canzoni albanesi, canti popolari arbëreshë e famose canzoni italiane di musica leggera tradotte in arbëresh, per finire con una danza in costume popolare.

Il programma del gemellaggio è continuato fino a lunedì 29 settembre con visite nel territorio: Terme di Castelnuovo, Mulino De Vita, Biscottificio De Mauro, Pastificio Andreola, aziende agricole della zona; visita a Lucera (castello, cattedrale, museo); visita all'azienda Massaro di Chieuti; visita alla Fiera dei prodotti e attrezzature agricole di San Matteo a Casalvecchio.

L'evento è stato presentato ampiamente anche dalla stampa nazionale e regionale.

F.to Edmond Çali